



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 540 Prot

Shkodër, më 16. 02.2018

V E N D I M

nr. 68, datë 16. 02.2018

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS TË STUDENTËVE QË PËRJASHTOHEN NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2017- 2018”**

Në mbështetje të Ligjit nr.80, dt.22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018, udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, dt. 06.02.2012” “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimi nr.24 datë 29.12.2017 “Për zbatimin e buxhetin e vitit 2018”, VKM-së nr.269 datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, pika 1, vendimit të BA nr. 64 datë 13.10.2017, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 16.02.2018

V E N D O S I

1. Të miratojë listat e studentëve përfitues të ciklit të parë që përjashtohen tërësisht nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2017-2018 sipas përcaktimeve të VKM-së nr.269 datë 29.03.2017 si dhe vendimit nr.64 datë 13.10.2017 nga sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë listat e studentëve përfitues të ciklit të dytë që përjashtohen në masën 50 % nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2017-2018 sipas përcaktimeve të VKM-së nr.269 datë 29.03.2017 si dhe vendimit nr.64 datë 13.10.2017 nga sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Miratimi përfundimtar i përjashtimeve të verifikohet nga Administratori pas konfirmimeve përkatëse të dokumenteve (konfirmimet të kërkohen deri me datë 31.12.2017)
4. Ky vendim i përcillet Administratorit të U.SH-së për zbatim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Bordit të Administrimit

Eduard NDRECA

